



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORT VJETOR 2020



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Shoqata Shqiptare e Bankave

Adresa: Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower 9/3, Tiranë

Regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin e Gjykatës nr.1153, datë 14 prill 1999

NIPT: K51626015F

Raporti Vjetor është një botim vjetor i përgatitur nga **Zyra Ekzekutive e AAB-së**, i disponueshëm në format digjital në faqen e internetit **www.aab.al**.

Informacioni në këtë Raport mund të përdoret vetëm për qëllime jo fitimprurëse, duke përmendur "Raporti Vjetor 2020", botuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB).

Ndalohet ndryshimi i pjesshëm apo i plotë i përmbajtjes së këtij Raporti.

Design & Layout: **FCB AFIRMA**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. MESAZH NGA KRYETARI	4
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE	6
3. ANËTARËT E SHOQATËS	9
4. PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE TË AAB-SË NË VITIN 2020	10
5. FAKTE DHE SHIFRA PËR 2020 - SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI	12
6. SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-SË	16
A) PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET	18
B) TRANSFORMIMI I SEKTORIT BANKAR	19
C) TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE TË BANKAVE	22
D) EDUKIMI FINANCIAR	27
E) KOMUNIKIMET, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE ADVOKIMI	29
7 KOMITETET TEKNIKE - PIKAT KRYESORE DHE ARRITJET	35
8. TAKIME TË TJERA	37
9. SHIFRA RRETH BANKAVE ANËTARE	39
10. PASQYRAT FINANCIARE	42

MESAZH NGA KRYETARI



Vijmë pas një viti të rrallë, të paprecedentë për gjeneratat tona. Betejë me Covid-19! Cilësia e jetës u prek në mënyrë të konsiderueshme, por ruajtja e shëndetit të punonjësve dhe klientëve ishte detyra jonë kryesore. Masa të shumta të karakterit organizativ, logjistik, operacional dhe rregullues përfshinë bankat si asnjëherë më parë për nga intensiteti dhe koha e veprimit. Të gjitha në funksion të vazhdimit të shërbimit bankar, pa ndërprerje asnjë moment, për të siguruar një mbështetje sa më të mirë dhe efektive për shoqërinë dhe ekonominë në përballimin e efekteve nga Covid-19.

Historia do të flasë dhe do të tregojë më shumë se çfarë ndodhi dhe si ndodhi, por ne jemi të sigurt se:

- politikat dhe strategjitë e bankave në lidhje me planet e rikuperimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë funksionuan më së miri, duke iu përshtatur fatkeqësisë Covid-19;
- investimet e bëra në vite për digjitalizimin e shërbimeve bankare siguruan vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve në distancë, pa prani fizike në degë;
- solidariteti dhe bashkëveprimi njohën vlera të reja. Mbi

I nderuar Lexues,

Në cilësinë e Kryetarit të AAB-së, kam kënaqësinë të prezantoj para jush Raportin Vjetor 2020 të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

23 mijë biznese dhe familje përfituan nga shtyrja e pagesave të kësteve të kredive, të cilët kanë kredi pranë bankave në vlerën 200 miliardë lekë;

- bankat u bënë kontribuuesit realë dhe më të fuqishëm për sigurimin e stabilitetit financiar. Mbi 220 milionë euro këste të shtyra u lanë në duar të kredimarrësve si likuiditet i shtuar menjëherë në treg;
- mbështetja e plotë dhe njëzëri e politikave qeveritare në lidhje me garancitë shtetërore për trajtimin e bizneseve të prekura nga Covid-19.

Në dallim nga çdo krizë e mëparshme, kriza e shkaktuar nga Covid-19 i gjeti bankat shumë të forta dhe të kompletuara. Masat e mara pas krizës së viteve 2008 – 2010 duket se shërbyen për të ndaluar përkeqësimin e fatkeqësisë. Bankat i rezistuan efekteve të fatkeqësisë dhe, për më tepër, ato nuk i amplifikuan efektet e saj në ekonomi apo në shoqëri. Kjo është një arritje tjetër dalluese e vitit 2020.

Individët dhe subjektet tregtare na testuan sërish dhe vërtetuan se mbështetja te sektori bankar është siguri për mbarëvajtjen e aktivitetit të tyre financiar.

Rritja e depozitave dhe e kreditimit, edhe pse në kushte të vështira të masave kufizuese për shkak të Covid-19, i forcuan lidhjet bankë-klientë. Nisma e ndryshimit që banka t'i përshtatet klientit, rezultoi e suksesshme duke materializuar rritje të përdorimit të shërbimeve online, përdorimit të kartave dhe kanaleve të tjera digjitale të shërbimit bankar. Dhe ne synojmë të rritemi edhe më shumë, prandaj edhe në dy muajt e fundit të vitit organizuam një fushatë të financuar nga MasterCard mbi përdorimin e kartave.

Viti 2020 ishte një vit i rëndësishëm edhe për vetë AAB-në. Statuti i ri i AAB-së u miratua duke ju përshtatur standardeve bashkëkohore dhe më të mira të organizimit strukturor, misionit dhe veprimtarisë së AAB-së.

Ky botim ka shumë detaje rreth veprimtarisë së AAB-së. Ju ftoj ta lexoni dhe jeni të mirëpritur të na sugjeroni për përmirësime të mundshme në vitet në vijim!

Me respekt,

Bledar Shella

Kryetar

Shoqata Shqiptare e Bankave

STRUKTURA ORGANIZATIVE

ASAMBLEJA E ANËTARËVE*

Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i AAB-së. Vetëm përfaqësuesi(t) i emëruar si duhet i anëtarëve mund të marrë pjesë në takimet e Asamblesë së Anëtarëve.

Në fund të vitit 2020, Asambleja e Anëtarëve përbëhej nga 12 anëtarë.

Lista e mëposhtme përshkruan në detaje Bankat Anëtare të AAB-së dhe Asamblenë e Anëtarëve:

Alpha Bank Albania / Georgios Papanastasiou, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Amerikane e Investimeve / Andi Ballta, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Kombëtare Tregtare / Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm & Anëtar Bordi

Banka Credins / Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm

Banka e Parë e Investimeve Albania / Bozhivar Torodov, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Intesa Sanpaolo Albania / Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm

Banka Procredit Albania / Agan Azemi, Anëtar i Bordit Drejtues

Mirsad Haliti, Anëtar i Bordit Drejtues

Banka Raiffeisen Albania / Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm

Banka OTP Albania / Bledar Shella, Drejtor i Përgjithshëm

Banka e Tiranës / Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm

Union Bank / Flutura Veipi, Drejtor i Përgjithshëm

United Bank of Albania / Amel Kovačević, Drejtor i Përgjithshëm

* E dhjetorit 2020

ANËTARËT E KOMITETIT EKZEKUTIV*

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Anëtarëve për një mandat dy vjeçar. Ajo përbëhet nga pesë anëtarë, tre prej të cilëve zgjidhen nga gjashtë banka që renditen të parat me pjesën më të madhe të totalit të aktiveve në sektorin bankar, ndërsa dy anëtarë të tjerë zgjidhen nga bankat e tjera anëtare.

Anëtarët që kanë përfunduar mandatet e tyre kanë mundësi të rizgjidhen.



Kryetar
Drejtore i Përgjithshëm,
Banka Intesa Sanpaolo Albania

SILVIO PEDRAZZI



Zëvendës Kryetar
Drejtore i Përgjithshëm,
Banka Credins

MALTIN KORKUTI



Anëtar
Drejtore i Përgjithshëm,
Banka Amerikane e Investimeve

ANDI BALLTA



Anëtar
Drejtore i Përgjithshëm,
Alpha Bank Albania

GEORGIOS PAPANASTASIOU



Anëtar
Drejtore i Përgjithshëm,
Banka e Tiranës

DRITAN MUSTAFA

* E dhjetorit 2020

SEKRETARIATI



*Sekretar i
Përgjithshëm*

SPIRO BRUMBULLI

Veprimtaritë e përditshme të Sekretariatit drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Bordi Drejtues. Disa nga detyrat e Sekretariatit, të cilat menaxhohen nga Sekretari i Përgjithshëm, janë si në vijim:

- » Të zbatojë vendimet e Asamblesë.
- » Të sigurojë që anëtarët të njoftohen për vendimet e Asamblesë së Anëtarëve dhe të Komitetit Ekzekutiv dhe që këto vendime të zbatohen si duhet.

- » Të përmbushë detyrat që i janë ngarkuar nga Komiteti Ekzekutiv.
- » Të përfaqësojë AAB-në në organet qeveritare, në gjykatë dhe me palë të treta (sipas autorizimeve të dhëna), në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- » Të vendosë në zbatim buxhetin vjetor dhe planin e biznesit.
- » Të hartojë informacione që do të publikohen nga Shoqata dhe t'ia përcjellë këto informacione Komitetit Drejtues.
- » Të mbikëqyrë llogaritë e AAB-së dhe të bashkëpunojë me audituesin.
- » Të hartojë dhe të nënshkruajë pasqyrat financiare të AAB-së.

Z. Spiro Brumbulli aktualisht mban pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të AAB-së.

KOMITETET TEKNIKE*

- » **Komiteti i Sigurisë së Bankës** / Bajram Ibraj, Kryetar, Banka Intesa Sanpaolo Albania
- » **Komiteti i Kartave** / Erion Maxhari, Kryetar, Banka e Parë e Investimeve Albania
- » **Komiteti i Përputhshmërisë** / Markelian Riska, Kryetar, Banka Intesa Sanpaolo Albania
- » **Komiteti i Burimeve Njerëzore** / Valbona Zeneli, Kryetare, Banka Raiffeisen Albania
- » **Komiteti i Sigurisë së Informacionit** / Dritan Gucaj, Kryetar, Banka OTP Albania
- » **Komiteti i Auditit të Brendshëm** / Dorida Stambolla, Kryetare, Banka Raiffeisen Albania
- » **Komiteti Ligjor** / Veronika Prifti, Kryetare, Banka Amerikane e Investimeve
- » **Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun** / Lutjana Konomi, Kryetare, Banka e Parë e Investimeve Albania
- » **Komiteti i Sistemeve të Pagesave** / Najada Xhaxha, Kryetare, Tirana Bank
- » **Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar** / Suela Totokoci, Kryetare, Banka Intesa Sanpaolo Albania
- » **Komiteti i Menaxhimi të Rrezikut** / Elona Bollano, Kryetare, Banka Kombëtare Tregtare
- » **Komiteti i Teknologjisë së Informacionit** / Alketa Lamce, Kryetare, Banka Intesa Sanpaolo Albania

* E dhjetorit 2020

ANËTARËT E SHOQATËS

AAB është anëtare, anëtare e asociuar ose partnere në organizatat e mëposhtme kombëtare dhe ndërkombëtare.



Anëtarësimet në nivel Kombëtar:

- » Këshilli Ekonomik Kombëtar
- » Këshilli Tatimor
- » Këshilli Ekonomik i Bashkisë së Tiranës
- » ICC Albania
- » Këshilli Kombëtar i Punës
- » Komiteti i Sistemit Kombëtar të Pagesave

Anëtarësimet në nivel Ndërkombëtar:

- » Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- » Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- » Forumi i Shoqatave të Bankave INTERBALKAN

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE TË AAB-SË NË VITIN 2020



- » Asambleja e Anëtarëve zhvilloi 3 takime dhe Komiteti Ekzekutiv zhvilloi 4 takime të tjera.
- » Statuti i ri i AAB-së: Në mars 2020, u shpallën procedurat e tenderimit për Statutin e ri për Shoqatën Shqiptare të Bankave. Në 10 dhjetor 2020, Asambleja e AAB-së miratoi Statutin e ri të AAB-së.
- » Prezantimi i gjetjeve - Pjesa e dytë e studimit "Besimi dhe perceptimi i klientëve ndaj bankave dhe sektorit bankar".
- » Organizimi i mëngjesit të punës me gazetarë të ekonomisë.
- » Trajnime tradicionale të ofruara online: Gjatë vitit, u organizuan 19 trajnime (në terren dhe online) me pjesëmarrjen e 275 punonjësve të bankave anëtare. Në klasa virtuale ndërkombëtare të zhvilluara nga Qendra e Trajnimeve morën pjesë 300 punonjës të bankave nga Shqipëria, përkatesisht në 58 trajnime.
- » Mbështetja e bankave gjatë emergjencës së pandemisë dhe periudhës së izolimit kombëtar, duke ofruar ndihmë për çështje të ndryshme operacionale (konkretisht, me leje lëvizje, mbulim mediatik, shërbime online, etj.)
- » Dy projekt garanci për kredi shtetërore, projektligji për amnistinë fiskale dhe penale, tre ligjet e Autoritetit

të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) dhe projektligji për regjistrin qendror të llogarive bankare.

- » Katër projektligje të nxjerra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, një ndryshim në udhëzimin "Për procedurat tatimore", një projekt rregullore e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë dhe dy projekt rregullore të nxjerra nga AMF.
- » Pjesëmarrja në "Forumin e Triestes për Investimet në Evropën Lindore - Investimet dhe Financat për Rimëkëmbjen Post-Covid", një forum rajonal ndërkombëtar i organizuar nga Federata Italiane e Bankave, Sigurimeve dhe Financave.
- » Komunikimi me institucione të ndryshme: Komisioni Parlamentar i Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKShI), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (AShK), FMN, Delegacioni i BE-së, Federata Evropiane e Bankave, BACEE dhe shoqatat e bankave të tjera të vendeve fqinje.
- » Ndjekja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e zbatimit të dy projekteve: Standardet e Përbashkëta të Raportimit (në funksionim që nga 15 nëntori) dhe Projekti i Fiskalizimit (faza e parë e projektit nis në 1 janar 2021).
- » Seminare dhe workshop-e online (webinare) mbi mashtrimet kompjuterike, krijimi i një kulture të angazhimit të punonjësve, fiskalizimi, standardet e përbashkëta të raportimit dhe 3 webinarë për sigurinë kibernetike gjatë tetorit 2020.
- » Mbulimi mediatik: 4 intervista me Kryetarin, 12 intervista me Sekretarin e Përgjithshëm dhe 6 intervista me anëtarët e Komiteteve Teknikë.
- » Fushatë e re për përdorimin e kartave gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2020, e sponsorizuar nga MasterCard.
- » Botime periodike të buletineve mujore, një seri statistikash, revista, Raporti Vjetor dhe Raporti i CSR-së.

PËRGJIGJJA E BANKAVE NDAJ COVID-19

AKTIVITETET E KOORDINUARA NGA AAB

Gjatë vitit, pandemia COVID-19 u shfaq si sfidë serioze në shqyrtim dhe bankat e gjetën veten duke trajtuar një gamë të gjerë prioritetesh në rritje që kërkonin ndërmarrjen e hapave konkretë.

Bankat ofruan gjithashtu një sërë programesh për të ndihmuar klientët individ dhe biznes të prekur nga pandemia, duke përfshirë heqjen e tarifave, shtyrjen e pagesave të kredive dhe lehtësira të tjera.

Në këtë seksion do të gjeni një sërë pikash kryesore lidhur me përpjekjet e koordinimit dhe bashkëpunimit për të trajtuar çështjet e pandemisë Covid-19.

Këto përpjekje përfshijnë:

- » Në 17 mars, si rezultat i situatës së shkaktuar nga COVID-19 dhe pas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe urdhrat të përbashkët të Kryeministrit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, pagesa e kësteve të kredisë për biznes dhe individ, të cilët po hasnin vështirësi për shlyerjen e pagesave, u shty për tre muaj. AAB koordinoi procesin e mbledhjes së të dhënave dhe ishte pjesë e korrespondencës midis institucioneve.
- » Përveç masës së përmendur të lehtësimit të pagesave të këstit të kredisë për tre muaj, disa banka hoqën komisionet e shërbimit online (home banking dhe/ose mobile banking), duke nxitur kështu përdorimin e kanaleve digjitale. Gjithashtu, u promovua tërheqja e parave pa komision në ATM të bankave të tjera.
- » AAB bashkëpunoi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për instrumentin e Garancisë Sovrane për shoqëritë e prekura nga ndikimi financiar i pandemisë.
- » Më 13 maj, AAB i drejtoi një shkresë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar zgjatjen e



afatit për subjektet biznes që aplikojnë për skemat përkatëse të garancisë.

- » Në 20 maj, Bankës së Shqipërisë iu dërgua një propozim për zgjatjen e afatit të moratoriumit të kredive.
- » Më 21 maj, AAB i përcolli Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të gjitha shqetësimet e bankave lidhur me Marrëveshjen e Garancisë për huatë e tregtarëve, për të mundësuar financimin e nevojshëm të orientuar drejt rikuperimit për aktivitetet tregtare të prekura nga situata e shkaktuar nga Covid-19. Në këtë kërkesë u trajtua heqja e pragut të parashikuar të kostos maksimale të financimit prej 5% (norma vjetore e interesit) dhe ulja e tij në marzhin maksimal prej 3% të indeksit të specifikuar në Marrëveshjen e Garancisë Sovrane nr. 2
- » Përmes shkresës drejtuar Bankës së Shqipërisë në 21 maj, sektori bankar i prezantoi autoriteteve një sërë propozimesh që synojnë minimizimin e efekteve të Covid-19 në ekonomi dhe në banka.
- » Komunikimi efektiv me mediat gjatë vitit - Kryetari i AAB-së dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së dhanë disa intervista dhe u ftuan në disa emisione dialogu për të shprehur qëndrimin e tyre mbi përgjigjen e bankave ndaj pandemisë COVID-19, të cilat u mbuluan gjerësisht nga kanalet kryesore të mediave në vend.

FAKTE DHE SHIFRA 2020

.....Kapacitetet e sektorit kanë shënuar rritje, duke i mundësuar këtij sektori të jetë pjesë e zgjidhjes dhe jo e problemit. Roli i bankave mbetet thelbësor, si gjatë fazës aktuale të kontrollit të pandemisë, ashtu edhe gjatë fazës së rikuperimit të ekonomisë në të ardhmen*.

TË PËRGJITHSHME:



Rreth 23 000 biznese dhe familje shqiptare përfituan nga masat lehtësuese, në vlerën rreth 200 miliardë lekë kredi në banka.



Rreth 220 milionë euro u lanë në duart e kredimarrësve nga shtyrja e pagesave të kësteve të kredive.



-3,31% Rritja vjetore e PBB-së.



1,6% Inflacioni mesatar për vitin 2020.



77,8% Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së.



0,5% Norma bazë e interesit.



Mbi 18% niveli i kapitalizimit të sektorit bankar.



12 banka, ku 4 janë me kapital shqiptar dhe 8 me kapital të huaj. Nga këto të fundit, 6 kanë origjinë nga vende të Bashkimit Evropian.



425 degë dhe agjenci bankare.

KREDIA:



6,8% Rritja mesatare e portofolit të kredisë.



4,6 pikë përqindjeje kontributi i rritjes nga kreditë për biznese.



2,2 pikë përqindjeje kontributi i rritjes nga kreditë për individë.



50% e portofolit të kredisë është në lekë.



10,5% Norma vjetore e rritjes së portofolit të kredisë në lekë.




8,1% Raporti i kredive me probleme ndaj numrit të kredive gjithsej.



41,7% Raporti i kredive ndaj PBB-së.

DEPOZITAT:



6,7% Norma vjetore e rritjes së depozitave.



80,2% Raporti i depozitave ndaj PBB-së.

PAGESAT:



50,1% të pagesave elektronike janë pagesa me kartë.



13,7% rritje e volumit të pagesave përmes bankingut nga shtëpia.



8,8% rritje e vlerës së transaksioneve përmes bankingut nga shtëpia.



7,03 transaksione me pagesa jo cash për llogari nëpërmjet internetit.




8,5% rritje e numrit të POS-ve.

PANDEMIA E COVID-19:



Lehtësira që lidhen me zbatimin e kërkesave rregullatore mbi klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve për provigjione për kreditë. Vlefshmëria e kësaj dispozite me një afat fillestar mars – maj 2020 u shty duke mbuluar edhe periudhën qershor – gusht të vitit 2020. Për kreditë e ristrukturuara, ky afat u shty deri në fund të vitit 2020.



Heqja e komisioneve të aplikuara nga bankat për transfertat elektronike të kreditit në lekë si dhe heqja e tarifave për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë;



Banka e Shqipërisë pezulloi shpërndarjen nga ana e bankave të fitimit të mbartur dhe të realizuar, fillimisht deri në qershor 2020 dhe më tej deri në fund të vitit;



Lehtësimi deri në masën e ponderimit me koeficient rreziku të ekspozimeve të bankave vendase ndaj titujve të borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj, për emetimet e titujve gjatë vitit 2020 deri në maturimin e tyre, si edhe përjashtimi i këtij ekspozimi nga përllogaritja e ekspozimit maksimal të lejueshëm;



Shtyrja e hyrjes në fuqi e ndryshimeve rregullatore që lidhen me kërkesat më të rrepta për ristrukturimin e kredive;



Një ndryshim në rregulloren “Për menaxhimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, ndryshim i cili do t’u lejojë bankave të përjashtojnë nga llogaritja e ekspozimit maksimal të lejueshëm këto lloj ekspozimesh;

SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-SË

Plani i Biznesit të AAB-së mbështetet fort në pesë shtylla dhe objektiva kryesore strategjike që mbështesin vizionin, misionin dhe qëllimet e Shoqatës.

- ✓ Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe bashkëpunimi me autoritetet
- ✓ Transformimi i sektorit bankar
- ✓ Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve të bankës
- ✓ Edukimi financiar
- ✓ Komunikimet, marrëdhëniet me publikun dhe mbrojtja ligjore

PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET

Kuadri ligjor dhe nënligjor

Përgjatë vitit 2020, sektori bankar është përfshirë në proces konsultimi për disa projektligje, një pjesë e të cilëve më pas janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tyre, si:

- Ligji “Për shkëmbimin automatik të informacionit”. Ky ligj u miratua në kuadër të angazhimit të Shqipërisë për të zbatuar Standardin e Përbashkët të Raportimit (CRS) të krijuar nga vendet e OECD-së, mbi shkëmbimin automatik të informacionit, për të luftuar problemin e evazionit fiskal offshore dhe shmangien e grumbullimit të parave jashtë vendit. Nëpërmjet këtij ligji do të realizohet shkëmbim automatik i informacionit të llogarive financiare me vendet pjesëmarrëse në marrëveshje dhe ky sistem do të funksionojë në një transmetim sistematik, periodik të të dhënave të tatimpaguesve nga ana e vendeve pjesëmarrëse.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shkëmbimin automatik të informacionit”
- Ligji “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, i cili synon përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator për sektorin e fondeve të investimeve dhe të letrave me vlerë.
- Ligji “Për tregjet e Kapitalit”, që synon zhvillimin e tregjeve të kapitalit, rritjen e mundësisë së financimit të ekonominë, rritjen e mundësitë për investitorët për fitime më të mira, rritjen e mundësive për ndërmjetësit, rritjen e rentabilitetit të infrastrukturës së tregjeve të kapitalit.
- Ligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, nëpërmjet të cilit rregullohen kushtet për licencimin, monitorimin, mbikëqyrjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe /ose monedhave virtuale, të agjentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbimeve novatore dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.
- Ligji “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”. Ky ligj ka si qëllim krijimin për herë të parë të një regjistri qendror

të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj përcakton funksionet e regjistrimit të llogarive bankare, mënyrën e raportimit dhe shfrytëzimit të të dhënave të llogarive bankare, si dhe aksesin dhe shfrytëzimin e këtij regjistri me qëllim identifikimin e pasurive të dyshuara me prejardhje nga veprimtari veprimtarive kriminale, nëpërmjet transaksioneve bankare. Ai parashikon gjithashtu dhe kufizime të parimit të së drejtës për informim bazuar në natyrën sekrete të të dhënave të regjistrimit.

- Dy vendimet e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e Këshillit të Ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave "Mbi kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes softuerike për procedurën e faturimit dhe fiskalizimit dhe procedurën dhe kriteret për regjistrimin e prodhuesve dhe mirëmbajtësve të programeve (softuer)".
- Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e faktorëve dhe situatave që merren parasysh në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
- Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë "Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e transaksioneve financiare të noterit dhe të fondeve të një klienti".
- Rregullorja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Mbi komunikimin me investitorët".
- Rregullorja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Mbi licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruuese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë".

Përmirësimet e Kuadrit Rregullator / Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë

Shoqata Shqiptare e Bankave është angazhuar dhe ka bashkëpunuar me Bankën e Shqipërisë përgjatë 2020. Megjithatë, këtë vit AAB ka pasur në fokus situatën e krijuar nga pandemia.

- Ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", të cilat konsistojnë në trajtimin me një peshë preferenciale rreziku prej 0% të ekspozimeve të bankave në tituj të borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj, për titujt e emetuar gjatë vitit 2020 deri në maturimin e tyre. Si dhe ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", nëpërmjet të cilit bankat mund të përjashtojnë nga llogaritja e ekspozimit maksimal të lejueshëm këto lloj ekspozimesh;
- Ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja", ku nëpërmjet shtimit të një dispozite të përkohshme në rregulloret e mësipërme, synohet të krijohet lehtësi subjekteve që në rastet që evidentoheshin paftësi paguese të kredimarrësve gjatë periudhës të përcaktuar (lidhur kjo me gjendjen e krijuar nga pandemia).
- Ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja", të cilat lidhen me moszbatimin e dispozitave për klasifikimin dhe provigjionimin e kredive deri në fund të muajit gusht 2020, si dhe për mënyrën e trajtimit të kredive të ristrukturuara gjatë vitit 2020, si dhe shtyrja e hyrjes në fuqi e ndryshimeve rregullative në lidhje me kërkesat më të shtrënguara për ristrukturimin e kredive, për datën 1.1.2022 (kjo në kuadër të gjendjes së krijuar nga pandemia).

BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET

Rigjallërimi i huadhënies dhe zvogëlimi i NPL-ve

Pas tryezës së rrumbullakët “Rigjallërimi i huadhënies dhe ulja e NPL-ve”, në Bankën e Shqipërisë dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u depozitua një përmbledhje e propozimeve të bankave. Më 5 shkurt u organizua një takim me Zëvendës Ministren Znj. Belinda Ikononi, ku u diskutuan hapat e mëtejshëm për zbatimin e propozimeve të dërguara më parë në Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila do të ndiqej nga një tjetër tryezë e rrumbullakët e mundshme me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar.

Amnisti fiskale dhe penale për subjektet që i nënshtrohen deklaramit vullnetar të pasurive

Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvilloi radhazi një sërë takimesh me aktorë të ndryshëm, përfshirë përfaqësuesit e AAB-së, në kuadër të procesit të konsultimit publik mbi projektligjin “Për amnistinë fiskale dhe penale për subjektet e deklaramit vullnetar të pasurive”.

- ✓ Në 7 korrik, përfaqësuesit e AAB-së morën pjesë në një takim online me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Diskutimet e këtij takimi u përqendruan në projektligjin e ri dhe detajet teknike të tij.
- ✓ Më 15 dhe 16 korrik, Sekretariati i AAB-së prezantoi përkatësisht pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Komitetit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave komentet dhe sugjerimet e unifikuara të bankave anëtare mbi projektligjin.
- ✓ Me 24 korrik, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, së bashku me përfaqësues të tjerë të bankave, morën pjesë në seancën dëgjimore të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, i cili u përqendrua në përpunimin e mëtejshëm të projektligjit. Pati një vlerësim të konsiderueshëm për komentet e paraqitura më parë nga komisioni i sektorit bankar.

Standardet e Zakonshme të Raportimit (CRS)

Sekretariati i AAB-së ishte pjesë e një korrespondence institucionale me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të trajtuar problematikat teknike të bankave në lidhje me Standardet e Përbashkëta të Raportimit (CRS) dhe aktet nënligjore të hartuara në zbatim të tyre, veçanërisht lidhur me shtyrjen e afatit të raportimit për institucionet financiare deri në 15 nëntor 2020 (një propozim që u mor parasysh nga ministria, duke sjellë kështu ndryshimin ligjor “Për shkëmbimin automatik të informacionit”).

- ✓ Më 31 janar, përfaqësuesit e departamenteve të përputhshmërisë dhe IT-së së bankave morën pjesë në një takim të përbashkët me DPT. Drejtoresha e Përgjithshme e DPT-së, Znj. Delina Ibrahimaj, mbajti një prezantim të shkurtër të Ligjit të miratuar “Për Standardet e Përbashkëta të Raportimit”. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e bankave ngritën disa nga çështjet kryesore në lidhje me projektvendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. Pas një sërë diskutimesh teknike, u vendos që në 7 shkurt të zhvillohej një takim tjetër teknik për të diskutuar versionin në shqip të projekt VKM-së, e cila fillimisht do t’u përcillet për shqyrtim të gjitha bankave.
- ✓ Më 8 gusht 2020, u organizua një takim online, me përfaqësues të departamenteve të IT-së dhe të përputhshmërisë së bankave dhe të DPT-së. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë përgjegjëse për zhvillimin e sistemit të raportimit.
- ✓ Më 24 shtator 2020, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim me përfaqësues të bankës nga Departamenti i IT dhe i Përputhshmërisë dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Takimi u përqendrua në problemet

teknike të CRS-së (SPR) (Standardit të përbashkët të raportimit). Në vijim, Sekretariati i AAB-së dhe përfaqësuesit e bankave mbajtën një korrespondencë të vazhdueshme me përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për çështje teknike dhe pasiguri në lidhje me procesin.

Procedurat Tatimore

AAB ishte një nga 22 shoqatat e biznesit që reagueshan dhe kundërshtuan ndryshimet në Udhëzimin Nr. 24 të Ministrit të Financave “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në këtë udhëzim, nëse subjekti, pas aplikimit të të gjitha masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore, nuk ka shlyer plotësisht të gjitha detyrimet tatimore, administrata tatimore ka të drejtë të transferojë detyrimet e mbetura tatimore të subjektit tek ortaku individ, aksionari dhe/ose administratori. Pas disa diskutimesh me palët e interesit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vendosi të ndërmarë nismën legjislative për një ndërhyrje dhe ndryshim në udhëzimin që parashikonte sanksione për sekuestron e llogarive bankare të ortakëve, aksionarëve dhe administratorëve.

Për fiskalizimin

Më 30 shtator 2020, me kërkesë të Sekretariatit të AAB-së, u organizua një takim teknik midis bankave dhe përfaqësuesve të grupit të punës së fiskalizimit të DPT. Takimi u përqendrua në disa nga problematikat kryesore teknike të industrisë bankare në lidhje me këtë projekt.

TRANSFORMIMI I SEKTORIT BANKAR

Plani i veprimit për E- Commerce (tregtia elektronike)

Në kuadër të Planit të Veprimit për përgatitjet në lidhje me tregtinë elektronike, më 11 dhjetor, grupi ndërinstitucional i punës zhvilloi një takim online. Si vijim i këtij takimi dhe me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në 21 dhjetor, Sekretariati i AAB-së u dërgoi autoriteteve përkatëse të gjitha komentet dhe sugjerimet e unifikuara të bankave mbi mundësitë dhe sfidat me të cilat përballet zhvillimi i tregtisë elektronike.

Pagesat e menjëhershme

Më 4 dhjetor, përfaqësuesit e AAB-së u takuan me ekipin e Grupit të Bankës Botërore dhe diskutuan mbi mjedisin aktual operacional dhe strukturën e kostos për pagesat nga individë, dhe sfidat e mundshme në zbatimin e një sistemi të tillë në Shqipëri. Në koordinim me Bankën e Shqipërisë dhe në vijim të masave të rëna dakord me 3 dhe 4 dhjetor, ekipi i Grupit të Bankës Botërore zhvilloi një seri takimesh me anëtarët kyç të industrisë sektoriale për të diskutuar mbi studimin e ekipit të planit për skenarët e zbatimit të pagesave të shpejta në Shqipëri.

Regjistri Qendror i Llogarive Bankare

Më 16 shtator, përfaqësues të bankave anëtare së bashku me Sekretariatit të AAB morën pjesë në një takim konsultativ me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të diskutuar në lidhje me projektligjin e ri “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare”. Takimi shërbeu për të prezantuar shqetësimet kryesore të sektorit bankar në këtë drejtim. Në vijim, një letër zyrtare iu drejtua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke theksuar komentet dhe sugjerimet përkatëse.

WORKSHOP-E & WEBINAR-E

Workshop me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT)

Në 25 qershor, u zhvillua një workshop mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare. Pas shqetësimeve të ngritura nga disa banka, AAB dhe DPT organizuan një takim online të përqendruar kryesisht në çështjet e IT-së. Pjesëmarrës në këtë takim ishin 25 përfaqësues të bankave.

Workshop me Bankën e Shqipërisë

Më 19 qershor, në bashkëpunim me Departamentin e Emisionit të Bankës së Shqipërisë dhe me kërkesë të bankave, u organizua një workshop online mbi projekt rregulloren “Për kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”.

Në vijim të veprimtarisë, komentet iu përcollën në Departamentin e Emisionit.

Aspektet pozitive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës për zgjidhjen e paaftësisë paguese - Rritja e Ndërgjegjësimit të Komunitetit të Biznesit

Webinari synoi të përmbledhë mënyrën se si kriza po ndikon në aftësinë paguese të firmave dhe individëve dhe ofroi një përmbledhje të përgjigjeve kryesore të politikave në ristrukturimin dhe paaftësinë paguese si për frenimin e krizës ashtu edhe për rimëkëmbjen pas krizës. Për më tepër, ky webinar theksoi aspektet pozitive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës për zgjidhjen e çështjeve të paaftësisë paguese, duke u përqendruar në promovimin e zbatimit të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve/ndërmjetësimit/negocimit dhe lehtësimit midis palëve (debitorëve dhe kreditorëve). Webinar-i u organizua brenda mandatit të Programit “Debt Resolution and Business Exit Program II”, mbështetur nga Ambasada Zvicerane - Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe u zhvillua online në 14 maj 2020.

Seminar me fokus në mashtrimin kompjuterik

Më 15 korrik 2020, Shoqata Shqiptare e Bankave, REAL Security dhe Grupi-IB organizuan një seminar informues dhe interaktiv plotësues me fokus në mashtrimet kompjuterike. Ekspertët kryesorë të industrisë ndanë opinionet e tyre mbi format kryesore të mashtrimit kompjuterik në ditët e sotme dhe mbi parandalimin në mënyrë efektive të sulmeve me të cilat ka më shumë të ngjarë të përballemi gjatë dhe pas periudhës së izolimit kombëtar.



Webinar lidhur me zgjidhjet bankare EnVISION ECM

Më 19 nëntor 2020, CBKSoft në bashkëpunim me AAB-në organizoi një webinar mbi menaxhimin e përmbajtjes së ndërmarrjes (ECM) dhe zgjidhjet bankare. Pjesëmarrësit mësuuan më shumë rreth Menaxhimit të Korrespondencës, procesit të deklarimit të llogarive (karakteristikat e integritetit), aplikimin për kartë krediti (karakteristikat e kapjes), dhe aplikimin online për kredi (menaxhimi i formës).



Aspektet pozitive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësore për zgjidhjen e paaftësisë pagueuse - Ngritja e ndërgjegjësimit për komunitetin e biznesit

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte i dyfishtë për shkak të situatës pandemike të Covid-19. Synimi ishte të përmbledhje të përgjigjeve mënyrën se si kriza ndikoi në paaftësinë pagueuse të firmave dhe individëve dhe ofroi një përmbledhje të përgjigjeve kryesore të politikave në ristrukturim dhe paaftësi pagueuse, si për kontrollin e krizës ashtu edhe për rimëkëmbjen pas krizës. Për më tepër, webinar-i theksoi aspektet pozitive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës për zgjidhjen e çështjeve të paaftësisë pagueuse, duke u përqendruar në promovimin e zbatimit të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve/ndërmjetësimit/negocimit dhe lehtësimit ndërmjet palëve (debitorëve dhe kreditorëve).

Webinar-i u organizua online me 14 maj 2020, brenda mandatit të Programit "Debt Resolution and Business Exit Program II", mbështetur nga Ambasada Zvicerane - Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), ku morën pjesë edhe përfaqësues të bankës.

TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE TË BANKAVE

AAB përfaqëson strukturën më të gjerë të trajnimeve për profesionistët e bankave. Gjatë vitit, të gjitha kurset e trajnimit u kthyen me sukses në formate virtuale.

Trajnime në AAB:

- Mbi 19 trajnime të zhvilluara.
- Mbi 275 punonjës të bankave të trajnuar.

Tema: Evolucioni i bankës digjitale (R) (në klasë)

Data: 30 - 31 janar 2020

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrja 29 pjesëmarrës

Përshkrimi: Qëllimi i këtij kursi ishte t'u ofrojë pjesëmarrësve një ide të Bankingut të Hapur dhe API-ve, FinTech dhe inovacionit në bankingun digjital, rregulloreve, mënyrën e prezantimit të inovacionit në Evropë, Identitetit Digjital, sigurisë dhe lidhjes me tregtinë elektronike; Teknologjitë e librit digjital në financën digjitale.



Tema: Menaxhimi eficient i projektit (në klasë)

Data: 26 -27 shkurt 2020

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrja 10 pjesëmarrës

Përshkrimi: Trajnimi trajtoi perspektivat e të punuarit në një mjedis eficient përmes aftësisë për të ofruar shpejt karakteristikat e klientëve në kohë dhe nëpërmjet aftësisë për t'u përgjigjur nevojave të tyre, duke balancuar fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë në një mjedis në ndryshim të vazhdueshëm.



Tema: Bankingu për individë, kanalet e reja të shpërndarjes dhe e-banking (në klasë)

Data: 2 - 4 mars 2020

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrja 21 pjesëmarrës

Përshkrimi: Trajnimi ofroi një këndvështrim global përmbledhës të strategjisë së shpërndarjes në lidhje me Bankingun për individë, kombinimin e kanaleve të ndryshme të shpërndarjes dhe transformimin e nevojshëm për të arritur suksesin.

Tema: Procesi i vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit të brendshëm dhe likuiditetit (ICLAAP): Një rishikim i bazuar në rrezik

Data: 9 - 10 mars 2020

Partnerë: Instituti Shqiptar i Audituesve të Brendshëm (ISHAB)

Pjesëmarrja 19 pjesëmarrës

Përshkrimi: Të kuptuarit e mënyrës se si ICAAP dhe ILAAP bashkëveprojnë me menaxhimin e Oreksit të Rrezikut dhe Planifikimin Strategjik, si edhe faktin se ICAAP dhe ILAAP përfaqësojnë më shumë sesa thjesht rutina raportimi. Ato janë elementë që me të vërtetë shtojnë vlerë në menaxhimin e bankave sot.



Tema: Rreziku i kredisë dhe analiza e rrjedhës së parasë (klasa virtuale)

Data: 13 - 14 maj dhe 20 - 21 maj 2020

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrja 13 pjesëmarrës

Përshkrimi: Kursi u përqendrua në raste të veprimtarisë së biznesit në jetën reale dhe organizimin e ushtrimeve në grup për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë në praktikë.



Tema: Menaxhimi i kohës dhe produktiviteti (klasë virtuale)

Data: 14 - 15 shkurt 2020

Partnerë: Qendra Lincoln

Pjesëmarrja 7 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky program u siguroi pjesëmarrësve instrumente për menaxhimin e aktiviteteve të tyre të punës në një mënyrë që i ndihmon ata të përmbushin sa më mirë objektivat personale dhe organizative.



Tema: Menaxhimi i shitjeve (klasë virtuale)

Data: 2 - 3 dhe 9 - 10 qershor 2020

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrja 9 pjesëmarrës

Përshkrimi: Në bashkëpunim me AIEEx, u organizua për herë të parë një trajnim online në platformën LMS në gjuhën shqipe.



Tema: Drejt Realitetit të ri – Aftësia ripërtëritëse e lidershipit

Data: 23 - 24 qershor 2020

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrja 19 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky kurs kishte për qëllim pajisjen e pjesëmarrësve me njohuritë e nevojshme mbi rëndësinë e aftësisë ripërtëritëse dhe energjisë në lidershipin efektiv dhe zhvillimin e ritualeve dhe rutinave të shkurtra, por ndikuese në aftësinë ripërtëritëse.



Tema: Rreziku i kredisë dhe analiza e rrjedhës së parasë
- Raste frymëzuese

Data: 6 - 7 dhe 13 - 14 korrik 2020

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrja 14 pjesëmarrës

Përshkrimi: Workshop-i u përqendrua në ndihmën ndaj ofruesve aktual dhe të ardhshëm të kredive, investitorëve dhe analistëve të kredisë për të kryer punën e tyre në mënyrë të plotë dhe efikente.



Tema: Analiza e Shkakut Thelbësor

Data: 8 - 9 tetor 2020

Partnerë: Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)

Përshkrimi: Trajnimi synoi të trajtonte praktikat më të mira të kategorive të RCA dhe se si këto mund të lidhen me vlerësimet e kulturës organizative.
Pjesëmarrja 10 pjesëmarrës



Tema: Zhdërvjelltësia për Fituesit

Data: 20-21 tetor 2020

Partnerë: AGISOLVE

Pjesëmarrja 7 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky trajnim interaktiv u lejoi pjesëmarrësve të përjetonin përvoja të lidhura me zhdërvjelltësinë, përkatësisht Scrum dhe Kanban. Njëkohësisht, ky trajnim ofroi një bazë të fortë për të kuptuar parimet dhe mendësinë që qëndron pas metodologjive të zhdërvjelltësisë.



Tema: Marketingu digjital

Data: 27 - 30 tetor 2020

Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)

Pjesëmarrja 16 pjesëmarrës

Përshkrimi: Kursi u përqendrua në zhvillimet më të fundit të marketingut digjital dhe përdorimin e mjeteve moderne më të fundit për krijimin e strategjive dhe fushatave të reja.



Tema: Rreziku i kredisë/palës tjetër dhe modelimi i rrezikut

Data: 4 - 6 dhe 9 - 11 nëntor 2020

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrja 15 pjesëmarrës

Përshkrimi: Ky kurs u siguroi pjesëmarrësve njohuri dhe kuptueshmëri më të mirë të rrezikut të kredisë/palës tjetër dhe metodat për menaxhimin efektiv të tij.



Tema: Parimet dhe mentaliteti i zhdivjelltesisë

Data: 12-13 nëntor

Partnerë: ATTF Luksemburg

Pjesëmarrja 12 pjesëmarrës

Përshkrimi: Pjesëmarrësit përfituan një kuptim më të thellë të një mentaliteti të zhdivjellës dhe mësuam mbi praktikatat e nevojshme për të integruar zhdivjelltesinë në biznesin e tyre të përditshëm.



Tema: Menaxhim projekti

Data: 16 - 18 - 20 nëntor


Partnerë: ATTF Luksemburg me Shoqatën e Bankave të Kosovës

Pjesëmarrja 6 pjesëmarrës


Përshkrimi: Pjesëmarrësit përfituan njohuri dhe kuptueshmëri më të mirë të menaxhimit të projektit, metodave dhe mjeteve të përdorura për të menaxhuar projektet dhe si të sigurojnë suksesin e projektit.




Tema: AML - Zbullo, freno dhe ndërprit
Data: 12 nëntor 2020
Partnerë: BACEE, mundësuar nga "Analysis International"
Pjesëmarrja 20 pjesëmarrës
Përshkrimi: Përditësimi i situatës evropiane në fushën e pastrimit të parave. Studime të thelluara të çështjeve. Pastrimi i parave i bazuar në tregti.





Tema: Menaxhimi i ekipeve në distancë
Data: 24 dhe 25 nëntor 2020
Partnerë: AIMS Albania
Pjesëmarrja 16 pjesëmarrës
Përshkrimi: Ky kurs kishte për qëllim të ndante praktikat më të mira të punës në distancë nga profesionistë danez me eksperiencë, për të cilët "Normaliteti i ri" është thjesht "Biznesi i zakonshëm".



Tema: Rreziku operacional - delegatët e sigurimit dhe përmirësimit
Data: 26 dhe 27 nëntor 2020
Partnerë: AIIA Albania
Pjesëmarrja 15 pjesëmarrës
Përshkrimi: Përfaqësuesit e pranishëm përfituan konceptet kryesore, shembujt dhe udhëzimet praktike për t'u zbatuar në misionin e tyre të përditshëm.



Tema: Menaxhimi i inovacionit në epokën e transformimit digjital
Data: 15 - 16 dhjetor 2020
Partnerë: Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)
Pjesëmarrja 17 pjesëmarrës
Përshkrimi: Ky trajnim ofroi një përmbledhje me reflektim të thellë mbi mjetet moderne të inovacionit dhe zhvillimet më të fundit në menaxhimin e inovacionit, të cilat u mundësuan praktikantëve të mësojnë më shumë përmes rasteve praktike.



EDUKIMI FINANCIAR

Leksione të hapura

- Më 16 janar 2020, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, Dr. Spiro Brumbulli organizoi një leksion të hapur: “Modeli i ri i bankingut”. Në këtë leksion morën pjesë studentë të programit të studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.
- Më 29 maj 2020, AAB bashkëpunoi me Universitetin Evropian të Tiranës dhe kryetaren e Komitetit të Auditorëve të Brendshëm, Znj. Dorida Stambolla, për të mbajtur një leksion të hapur mbi sfidat e vazhdueshme me të cilat përballet auditi i brendshëm.



Takimi i 8-të i organizuar (ANFE)

Me 29 janar 2020, nën kujdesin e Shoqatës Shqiptare të Bankave, Rrjeti Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE) organizoi takimin e tij të 8-të. Takimi u përqendrua në strategjinë dhe iniciativat e edukimit financiar.



Muaji Evropian i Sigurisë Kibernetike

Tetori shënon Muajin Evropian të Sigurisë Kibernetike. AAB dhe Komiteti i tij i Sigurisë së Informacionit organizuan një seri webinar-esh që u zhvilluan gjatë gjithë muajit. Ngjarjet digjitale të këtij viti synuan të eksplorojnë tendencat dhe sfidat kibernetike për zhvillimin e shpejtë të bankave dhe të ndihmojnë njerëzit të identifikojnë dhe të përgatiten për kërcënimet kibernetike.

- 15 tetor 2020 - Webinar-i i parë mbi “Sigurinë kibernetike në epokën digjitale” i përqendruar në rreziqet dhe sfidat e botës digjitale, rritjen e kompleksitetit të sistemeve të informacionit, a mund të gjendet një ekuilibër midis kërkesave në rritje të përdoruesve të internetit dhe sigurisë, si dhe disa këshilla praktike për blerje të sigurta online.
- 22 tetor 2020 - Webinar-i i dytë me temë “Siguria kibernetike dhe sfidat në kohën e distancimit social” u përqendrua në rreziqet e hasura në hapësirën kibernetike, mashtrimet përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, siguria gjatë punës në distancë si dhe disa këshilla praktike mbi sigurinë e informacionit, etj.

- 29 tetor 2020 - Webinar-i i tretë me temë “Siguria kibernetike dhe përvoja shqiptare” trajtoi çështjet legislative dhe rregullatore të sistemit dhe mënyrat për një bashkëpunim më të mirë.



Dita Botërore e Kursimit

Më 31 tetor 2020, me rastin e Ditës Botërore të Kursimit dhe duke synuar promovimin e kursimeve për të planifikuar më mirë nevojat dhe mundësitë për një jetë më të mirë, AAB organizoi një konkurs online për grup moshën nga 13-15 vjeç.



Webinar me temë “Zbatimi i një qasjeje të bazuar në sjellje ndaj shërbimeve financiare”

Banka Botërore bashkëpunoi me AAB-në për të organizuar një webinar te temë “Zbatimi i një qasjeje të bazuar në sjellje ndaj shërbimeve financiare”. Ky webinar ishte pjesë e Akademisë Greenback, një seri trajnimesh për ofruesit e shërbimeve financiare të projektuara nga Banka Botërore në partneritet me AAB-në, në kontekstin e programit të remitancave dhe pagesave. Kjo iniciativë zbatohet në partneritet me Bankën e Shqipërisë dhe mbështetjen financiare të Qeverisë Zvicerane. Webinar-i u zhvillua në 18 nëntor 2020.



KOMUNIKIMET, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE ADVOKIMI

Ndërsa pandemia ndryshoi mënyrën e të jetuarit dhe të punës, Shoqata vijoi të ishte një burim informacioni. AAB-ja e zhvendosi fuqinë e ndërlidhjes te platformat online dhe siguroi përditësime në kohë reale për autoritetin mbikëqyrës dhe qeverinë për shtyrjet e pagesave të kredive, skemat e reja të huazimit dhe skemat e garancisë së huasë.

Gjatë këtij viti, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së janë ftuar shpeshherë të mbajnë fjalime ose të marrin pjesë në aktivitete në Shqipëri dhe kudo në Evropë, me qëllim shpalosjen e këndvështrimit të këtij sektori lidhur me aktualitetet kryesore. Përfaqësuesit e AAB-së vijuan të prezantojnë pozicionin e AAB-së për çështjet në lidhje me të. Prezenca në media gjatë vitit 2020: 4 intervista me Kryetarin, 12 intervista me Sekretarin e Përgjithshëm dhe 6 intervista me anëtarët e Komiteteve Teknike.

AKTIVITETET ME GAZETARËT E EKONOMISË



Mëngjes pune për gazetarët e ekonomisë dhe përfaqësuesit e mediave

Më 28 shkurt 2020, AAB organizoi një mëngjes pune me përfaqësues të mediave vizuale dhe shtypin e shkruar, në kontekstin e fuqizimit të marrëdhënieve të punës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të komunikimit midis dy sektorëve. Në takim morën pjesë menaxherë dhe anëtarë të departamenteve të marketingut dhe komunikimit të bankave anëtare të AAB-së, si dhe gazetarë dhe përfaqësues të mediave. Pjesëmarrësit u mirëpritën nga Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi, ndërsa takimi vijoi në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, ku pjesëmarrësit shkëmbyen mendimet dhe idetë e tyre për një bashkëpunim më të frytshëm.

PJESËMARRJA NË TAKIME DHE KONFERENCA KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Në vitin 2020, Shoqata Shqiptare e Bankave ishte pjesëmarrëse në takime të ndryshme rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aktivitete virtuale. Përfaqësuesit e saj (Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm) kanë bërë prezantime të ndryshme dhe kanë dhënë kontributin e tyre gjatë këtyre aktiviteteve.

Kryetari i AAB-së, z. Silvio Pedrazzi në takimin me temë “Banka - Marrëdhëniet e biznesit: Sfidat e përbashkëta ekonomike përballë pandemisë globale Covid-19”

Më 13 maj 2020, Banka e Shqipërisë organizoi një forum diskutimi me sistemin bankar dhe komunitetin e biznesit me temë: “Banka - Marrëdhëniet e biznesit: Sfidat e përbashkëta ekonomike përballë pandemisë globale





Covid-19". Takimi u iniciua dhe u organizua nën kujdesin e Guvernatorit Sejko dhe kishte për qëllim inkurajimin e bashkëpunimit midis këtyre dy grupeve të interesit, për të përballur sfidat e përbashkëta ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19 dhe për të siguruar një platformë për të ndarë pikëpamjet dhe nevojat për instrumentet që do të angazhohen dhe masat e mëtejshme që do të ndërmerren.

Në fjalimin e mbajtur në këtë takim, Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave, Z. Silvio Pedrazzi theksoi përgjegjësinë, profesionalizmin dhe angazhimin e sektorit bankar në këtë situatë të jashtëzakonshme, duke siguruar gamën e plotë të shërbimeve financiare në përgjigje të nevojave të komunitetit. Në këtë kontekst, Z. Pedrazzi vlerësoi masat lehtësuese të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë dhe autoritetet publike dhe bëri thirrje për më shumë mbështetje legjislative.

Mëngjes pune me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së

Kryetari i AAB-së dhe CEO i Intesa Sanpaolo Bank Albania, Z. Silvio Pedrazzi, i shoqëruar nga disa CEO të bankave tregtare, zhvilloi një mëngjes pune me Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare (AMF), Z. Ervin Mete dhe përfaqësues të tjerë të institucionit. Gjatë takimit, u diskutuan çështje të ndryshme legjislative si p.sh. ligjet e reja "Për ndërmarrjen e investimeve kolektive" dhe "Për tregjet e kapitalit në Shqipëri" të miratuara së fundmi nga Parlamenti. Përfaqësuesit e AMF-së dhe AAB-së treguan gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe organizuar aktivitete të përbashkëta, me qëllim sigurimin e edukimit financiar për të gjithë pjesëmarrësit e tregut financiar.

5 Vjetori i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Z. Silvio Pedrazzi, Kryetari i AAB-së dhe CEO i Intesa Sanpaolo Bank Albania morri pjesë në forumin "OBZH-të dhe Sektori Privat në Shqipëri", një forum i cili ofroi një platformë për të diskutuar një larmi temash midis aktorëve dhe palëve të interesit në panel. Panelistët ndanë përvojat e tyre në lidhje me mënyrat se si shoqëritë e biznesit kanë integruar në mënyrë të prekshme OBZH-të në proceset e tyre financiare dhe operationale dhe vendimarrjen e brendshme, dhe gjithashtu ndanë pikëpamjet mbi ndryshimin e mjedisit të biznesit në kuadër të ndryshimeve globale.

Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së në mbledhjen plenare të Këshillit të Investimeve

Më 5 qershor 2020, Këshilli i Investimeve (IC) zhvilloi një takim plenar përmes telekonferencës në platformën Zoom për të diskutuar sugjerimet kyçe nga ana e biznesit për rimëkëmbjen ekonomike të vendit pas pandemisë së Covid-19. Takimi u ndoq nga të gjithë anëtarët e IC (institucionet shtetërore, anëtarët e biznesit dhe partnerët kyç për zhvillimin), si dhe përfaqësues të tjerë të lartë nga shoqatat e biznesit dhe komuniteti i donatorëve. AAB u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm i saj.

Kryetari i AAB-së në forumin "Aksesi në Politikën e Financave - Mbështetje për Produktet Shqiptare"

Më 2 nëntor 2020 u zhvillua forumi i dytë i dialogut "Aksesi në Politikën e Financave - Mbështetje për Produktet Shqiptare", një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për politikën për të mbështetur produktet shqiptare. Tryeza e këtij forumi mblodhi së bashku përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, politikëbërësit, sistemi bankar dhe sipërmarrja. Ministria Denaj përditësoi pjesëmarrësit mbi skemat e garancisë sovranë që qeveria, së bashku me bankat, siguruan për bizneset për të mbuluar nevojat për likuiditet, si dhe për skemat mbështetëse dhe këshilluese të ofruara përmes AIDA-s. Gjatë diskutimeve, Kryetari i AAB-së, Z. Silvio Pedrazzi

theksoi mbështetjen e ofruar nga bankat tregtare për kreditimin e sektorit të ekonomisë, veçanërisht ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së në Forumin e Triestes për Investimet në Evropën Lindore 2020

Më 9 qershor, 2020, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, Z. Spiro Brumbulli mori pjesë në Forumin e Triestes për Investimet në Evropën Lindore 2020, i cili u organizua në formë virtuale. Folësit kryesorë diskutuan mbi tema të tilla si konteksti i ri gjeopolitik pas goditjes nga pandemia, mbrojtja sociale dhe mundësitë e investimit dhe financimit, faza e rimëkëmbjes - zhvillimi i tregjeve lokale të kapitalit për të financuar zhvillimin dhe rritjen e likuiditetit. Gjatë prezantimit të tij, Z. Brumbulli nënvizoi rolin e sektorit bankar në shërbim të ekonomisë reale dhe sfidat për bankat vendase. Forumi i Triestes ka shërbyer si një vend tradicional i takimeve dhe diskutimeve midis politikëbërësve, profesionistëve rregullatorë, akademisë dhe aktorëve të sektorit të shërbimeve financiare nga vendet e Evropës Jug-Lindore (SEE) që nga viti 2016.

Diskutim i Këshillit të Investimeve lidhur me sfidat dhe rekomandimet për të përfituar nga potencialet e investimeve në sektorin e agropërpunimit

Më 10 nëntor 2020, Këshilli i Investimeve (KI) zhvilloi një takim plenar virtual për të diskutuar sfidat kryesore dhe rekomandimet për promovimin e investimeve në sektorin e agropërpunimit. Takimi u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj, dhe u ndoq nga pothuajse të gjithë anëtarët e KI. Në kuadër të këtij takimi, u përkatit dhe u prezantua një studim teknik. Përveç analizës së zakonshme të kërimit nga zyra, analiza përfshiu gjetjet e nxjerra nga një pyetësor i kryer me 42 shoqëri agropërpunuese, si dhe informacione dhe të dhëna përkatëse në lidhje me qasjen në financa për këtë sektor, të dhëna këto të siguruar nga 8 banka tregtare. Fjalimi i Sekretarit të Përgjithshëm të AAB-së theksoi rolin e bankave në sigurimin e mbështetjes financiare dhe qasjen në kredi bankare për NVM-të.

Konferenca e 40-të Rajonale e BACEE

Më 17 nëntor 2020, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, Z. Spiro Brumbulli mori pjesë në Konferencën e 40-të Bankare Rajonale të BACEE, të zhvilluar online. Në prezantimin e tij, ai mbuloi shkurtimisht çështje të tilla si: situata e shkaktuar nga COVID-19, statistikat e fundit, masat kufizuese, masat kryesore të qeverisë për të mbështetur ekonominë, situata e sektorit bankar, rezultatet e T3, perspektivat, etj. 149 pjesëmarrës nga 26 vende dhe 74 institucione morën pjesë në këtë Konferencë virtuale dhe AAB ishte një nga sponsorët e argjenditë.

Takimi VI i Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave

Në 17 dhjetor 2020, Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave (KKSP) zhvilloi takimin e tij të radhës. Përveç anëtarëve të KKSP-së, në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të tjerë nga institucionet financiare ndërkombëtare, ekspertë të sistemit financiar dhe të pagesave, përfaqësues të sistemit bankar si dhe përfaqësues të sistemit financiar jobankar. Z. Spiro Brumbulli, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, mori pjesë në takim dhe mbajti një prezantim mbi iniciativat e arsimit financiar të AAB-së gjatë viteve dhe fushatën e fundit informuese të AAB-së për të rritur ndërgjegjësimin e klientëve për përdorimin e kartave bankare.

Për më tepër, Sekretariati i AAB-së mori pjesë në disa aktivitete të organizuara nga institucione të ndryshme, të tilla si: Webinar - Implikimet për ekonominë Evropiane dhe disa prej çështjeve më të gjera rreth Përfshirjes Financiare, Webinar - Hapja e llogarive bankare në Qipro, Greqi, Rumani, Bullgari, Malin e Zi dhe Serbi, takimi në kuadër të Projektit "Bashkëpunimi Ndërkufitar dhe Konkurrenca për NVM-të (3C4SME), Takimi i Përgjithshëm i Asamblesë së Shoqatës së Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE), Takimi i anëtarëve të Federatës Evropiane të Bankave (EBF), Takimi virtual i Grupit të Projektit të Edukimit Financiar EBF.

PUBLIKIME

Për sa i përket botimeve, botimet e Shoqatës Shqiptare të Bankave ishin si në vitet e mëparshme:

Revista “Bankieri”

Katër edicione të revistës “Bankieri” u përgatitën dhe u botuan në dy gjuhë në vitin 2020. Në to përfshihen artikuj të shkruar nga ekspertë bankarë, akademikë, përfaqësues të biznesit, etj. 900 kopje në muaj u shpërndanë në banka, institucione, individë, shoqata, universitete dhe media. Revistat gjenden në version të shkarkueshëm në internet në profilet e rrjeteve sociale të AAB-së.



Raporti Vjetor 2019

një botim vjetor në shqip dhe anglisht, i disponueshëm në format digjital në faqen e internetit www.aab.al.



Raporti Vjetor i CSR: Bankat për shoqërinë, 2019

botim vjetor në shqip dhe anglisht.



Buletinet elektronike

të publikuara dhe shpërndara tek anëtarët çdo muaj. Këto buletine u drejtohen vetëm bankave anëtare dhe synojnë të informojnë dhe përditësojnë lexuesit mbi aktivitetet kryesore të Shoqatës, takime me autoritete dhe organizata të ndryshme për çështje të diskutuara në lidhje me sektorin bankar, pjesëmarrjen e përfaqësuesve të AAB-së në takime të ndryshme dhe takimet e Komiteteve të Shoqatës.

Statistikat

AAB publikoi në faqen e saj zyrtare në internet të dhënat tremujore të pa-audituar mbi treguesit kryesorë të sistemit bankar sipas SNRF, si dhe të dhënat totale mujore për të gjithë sistemin.

Studimi mbi “Besimin dhe Perceptimin e Klientit në Banka dhe Sektorin Bankar”, pjesa e dytë

Në 23 janar 2020, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) organizoi një aktivitet për të prezantuar gjetjet e pjesës së dytë të studimit. Aktiviteti u ndoq nga bankat anëtare, Banka e Shqipërisë, institucione shtetërore, institucione financiare jobankë, institucione financiare ndërkombëtare, bashkëpunëtorë të AAB-së dhe përfaqësues të mediave.




FUSHATË SENSIBILIZUESE PËR PËRDORIMIN E KARTAVE

AAB, në bashkëpunim me MasterCard, prezantoi një fushatë informuese për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve për përdorimin e kartave bankare për të zvogëluar transaksionet e parave cash në ekonomi. Nën sloganin: “Ftillohu! Ecni me kohë dhe jini praktik me mënyrat më të fundit të pagesave. Shmangni Cash, Paguani me Kartë!”, Fushata ekspozoi mënyrën tradicionale të përdorimit të parave cash, duke theksuar se sajopraktike dhe “e tejkaluar” është kjo mënyrë pagese. Koncepti u prezantua vizualisht me dy objekte (i vjetër/i ri) të vendosura pranë njëra-tjetrës në formë krahasimi. Më 4 nëntor 2020, AAB, përmes një konference për shtyp, nisi fushatën në media. Fushata u shtri për gati dy muaj deri në fund të dhjetorit 2020.


FTILLOHU!

Ec në kohë dhe bëhu praktik me metodat e reja të pagesës. Evito Cash. Paguaj me Kartë!



FTILLOHU!

Ec në kohë dhe bëhu praktik me metodat e reja të pagesës. Evito Cash. Paguaj me Kartë!



FTILLOHU!

Ec në kohë dhe bëhu praktik me metodat e reja të pagesës. Evito Cash. Paguaj me Kartë!





MEDIAT SOCIALE

Gjatë vitit 2020, angazhimi ndaj përmbajtjes në rrjetet sociale të AAB-së u rrit dhe po ashtu u rrit edhe numri i ndjekësve në profilet e AAB-së në media sociale, krahasuar me vitin e kaluar.

Instagram		facebook		Linkedin	
2019	421 ndjekës	2019	5756 pëlqime	2019	5872 ndjekës
2020	661 ndjekës	2020	6067 pëlqime	2020	7098 ndjekës

AKTIVITETE SOCIALE

Darka vjetore

Më 11 shkurt 2020 u zhvillua takimi i Asamblesë së Anëtarëve, duke u përqendruar kryesisht në diskutimet kryesore mbi përditësimet e organizimit të Shoqatës dhe, në këtë kontekst, u mor një vendim për të rishikuar Statutin e AAB-së. Fokusi i rishikimit do të jetë: (i) qeverisje e re e Shoqatës; (ii) përcaktimi i detyrave për komitetet teknike; (iii) rregullorja e re për funksionimin e komisionit. Gjithashtu, anëtarët e Asamblesë vendosën të zgjasin mandatin e Z. Silvio Pedrazzi, në postin e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv dhe Kryetar i AAB-së, dhe mandatin e Z. Maltin Korkuti, si anëtar i Komitetit Ekzekutiv dhe Zëvendës Kryetar i AAB-së deri në fund të vitit 2020. U miratua gjithashtu buxheti i AAB-së për vitin 2020.

Pas këtij takimi, AAB organizoi Darkën Vjetore, veprimtarinë e saj tradicionale gala me rastin e përfundimit të një viti financiar dhe përgatitjen për vitin pasardhës. Në këtë veprimtari morën pjesë Drejtorët e Përgjithshëm të bankave anëtare, të ftuar të veçantë nga Banka e Shqipërisë, Guvernatori, Zëvendës Guvernatori i Parë dhe Zëvendës Guvernatori i Dytë, Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe drejtorë të tjerë. Një përshëndetje e veçantë iu dedikua Z. Gazmend Kadriu, me rastin e përfundimit të misionit të tij si Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank.



KOMITETET TEKNIKE

– ÇËSHTJET KRYESORE DHE ARRITJET

Komiteti i Sigurisë së Bankës

Gjatë gjithë vitit, anëtarët e komitetit diskutuan çështjet e sigurisë me të cilat përballen mjediset e punës dhe sfidat e tjera të hasura. Në shumë raste, këto komitete patën një bashkëpunim të ngushtë me autoritetet shtetërore për çështje me të cilat bankat përballen në kontekstin e pandemisë.

Në tetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së dhe Kryetari i Komitetit të Sigurisë të AAB-së morën pjesë në takimin e Komitetit të Sigurisë Kombëtare të Aviacionit Civil. Diskutimet u përqendruan në transportin e ngarkesave të vlefshme dhe hapat vijues për të përmirësuar sistemin e transportit, pas reagimeve të Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në 21 dhjetor 2020, përfaqësuesit e Komitetit u takuan me Shefin e Komisarariatit të Policisë në Rinas për të diskutuar vendimin e marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i cili lëshoi një urdhër për tërheqjen e forcave nga Aeroporti i Rinasit, dhe çështjen e transportit të vlerave monetare drejt/nga Aeroporti i Rinasit.

Komiteti i Kartave

Anëtarët e komitetit diskutuan për çështje me interes të përbashkët, si p.sh.: Reduktimi i Shkëmbimit (pagesat kombëtare), aktivitetet në lidhje me industrinë e kartave, mandatet e Visa dhe Mastercard, çështjet në lidhje me mashttrimet, etj. Për më tepër, anëtarët bashkëpunuan në përhapjen e informacionit dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit.

Komiteti i Komunikimit & Marrëdhënieve me Publikun

Publikimet periodike të AAB-së dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm ishin ndër temat kryesore të takimit të organizuar në 28 janar. Anëtarët e komisionit u angazhuan në një sërë aktivitetesh me gazetarë ekonomikë, si p.sh.: mëngjes pune i organizuar në muajin shkurt dhe konferenca për shtyp mbi lëshimin e kartave, duke paraprirë fushatën e ndërgjegjësimit të organizuar më vonë në muajin nëntor.

Komiteti i Burimeve Njerëzore

Anëtarët e komitetit diskutuan mbi masat qeveritare të vendosura për institucionet financiare në kuadër të pandemisë COVID-19. Disa nga temat e tjera me interes përfshinin: trajnimet online të ofruara nga AAB në bashkëpunim me partnerë të tjerë dhe pjesëmarrja e bankave anëtare në Sondazhin e Pagave dhe Shpërblimeve me Korn Ferry.

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Më 6 maj, komiteti zhvilloi një takim online për të diskutuar dhe shkëmbyer përvojat e tyre në mënyrën se si ata vazhdojnë të menaxhojnë me përgjegjësi punën e tyre në përgjigje të normalitetit të ri si rezultat i pandemisë Covid-19. Maji është Muaji Ndërkombëtar i Ndërgjegjësimit të Auditimit të Brendshëm. Me qëllim promovimin e vlerave të auditimit të brendshëm gjatë këtij muaji, AAB bashkëpunoi me Universitetin Evropian të Tiranës dhe më 29 maj Kryetarja e Komitetit Znj. Dorida Stambolla, mbajti një leksion të hapur me temën “Sfidat e vazhdueshme për auditimin e brendshëm”.

Më 23 dhjetor, Komiteti organizoi takimin e tij online. Agjenda përfshiu diskutime mbi sfidat me të cilat përballen auditimi në vitin 2020, përparësitë dhe mënyrat e reja të punës për 2021. Për më tepër, anëtarët përgatitën një listë të temave për trajnime për të cilat kanë nevojë punonjësit e departamentit të auditimit të brendshëm.

Komiteti i Sigurisë së Informacionit

Gjatë mbledhjes online me 10 qershor 2020, anëtarët diskutuan mbi masat lehtësuese të ndërmarra gjatë pandemisë dhe gjetjet nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) si dhe lidhur me deklaratën që infrastrukturën kritike janë përballur me probleme gjatë sulmeve të improvizuara nga Autoriteti.

- Në 11 shtator, Komiteti i Sigurisë së Informacionit të AAB-së zhvilloi një takim, ku u diskutuan shqetësimet kryesore teknike të bankave anëtare në lidhje me nënshkrimin elektronik dhe dokumentet elektronike.
- Në 17 shtator, Sekretariati i AAB-së organizoi një takim online me përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ku kjo e fundit sqaroi shqetësimet e ngritura nga bankat. Si vijim, Sekretariati i drejtoi zyrtarisht Autoritetit kërkesat e Komitetit dhe informoi anëtarët përkatësisht.
- Më 28 shtator, kryesia e diskutimeve të komitetit u përqendrua në planifikimin e aktiviteteve të sigurisë kibernetike që u zhvilluan gjatë Muajit Evropian të Sigurisë Kibernetike. Aktiviteti digjital i këtij viti synoi të eksplorojë tendencat dhe sfidat kibernetike në zhvillim të shpejtë.

Komiteti Ligjor

Kryesia e komitetit u mbledh për të diskutuar më në detaje të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e bankave anëtare në lidhje me projekt rregulloren “Për përcaktimin e rregullave për rregullimin e transaksioneve financiare të noterëve dhe fondeve të klientëve dhe të palëve të treta”. Sekretariati i AAB-së dorëzoi materialin me të dhënat përmbledhëse përmes një shkrese zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Pas rekomandimit të komitetit, Sekretariati i drejtoi një kërkesë zyrtare Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e duhur të Udhëzimit Nr. 1361, datë 2.05.2020 “Për nënshkrimin elektronik të akteve kadastrale për shërbimet e siguruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe procedurat e punës”.

Më 22 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, së bashku me kryesinë e Komitetit Ligjor, morën pjesë në një takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Dhomave Amerikane të Tregtisë (AmChams) dhe Confindustria për të diskutuar mbi ndryshimin e Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me bllokimin e llogarive bankare.

Pas diskutimeve të anëtarëve të KE, Sekretariati i AAB-së, në bashkëpunim dhe me kontributin e grupit të punës të përbërë nga avokatë të bankave dhe kryesia e Komitetit Ligjor, i drejtuan një shkresë zyrtare që përmban të gjitha shqetësimet dhe propozimet e bankave mbi pasojat e ligjit “Anti-mafia” mbi interesat e titujve dhe letrave me vlerë të bankave.

Komiteti i Menaxhimit të Riskut

Më 3 shkurt 2020, komiteti organizoi një takim të përqendruar në platformën për rjetësimin e huasë. U krijuan disa grupe pune për të përmbushur dhe ekzekutuar afatet e planit, të përqendruar në disa nga objektivat e platformave. Gjatë muajit, sipas kërkesave të platformës, Sekretariati u dërgoi dy shkresa autoriteteve përkatëse dhe institucioneve partnere, d.m.th. : “Mbi praktikën më të mira për marrëveshjet e ndarjes së rrezikut” dhe platforma “e-Albania”. Për më tepër, Sekretariati i drejtoi Bankës së Shqipërisë një kërkesë për të vijuar zbatimin e peshës së rrezikut prej 50% për investimet në letra me vlerë të qeverisë shqiptare në valutë të huaj. Gjatë vitit, Sekretariati bashkëpunoi me anëtarët e Komitetit për t’i siguruar autoritetit mbikëqyrës dhe qeverisë përditësime në kohë reale mbi shtyrjet dhe huazimet..

Komiteti i Thesarit dhe Tregut Financiar

Më 10 janar u mbajtën zgjedhjet e kryesisë së komitetit. Kryesia e re e komitetit përbëhet nga: Znj. Suela Totokoci nga Intesa Sanpaolo Bank Albania, Kryetare; Znj. Teuta Cinari nga ABI Bank, Nënkryetare dhe Znj. Donalda Gjorga nga Raiffeisen Bank, Anëtare e Kryesisë. Për më tepër, përditësimet dhe progresi i projektit Market Markers ishte pjesë e agjendës.

Komiteti diskutoi dhe shkëmbeu opinione mbi procesin e ndryshimit/zëvendësimit të normave të interesit referues, si një kërkesë nga Banka e Shqipërisë.

TAKIME TË TJERA GJATË 2020

Shoqata organizoi një seri takimesh që sollën së bashku në një vend vendimmarrës të lartë nga bankat anëtare dhe ekspertë nga një gamë e gjerë sektorësh, duke ofruar mundësi unike për dialog dhe shkëmbim të nivelit të lartë në lidhje me tematikat në zhvillim dhe me përparësi.

TAKIME ME INSTITUCIONET PUBLIKE

Takim me Dhomën e Tregtisë të Diasporës Shqiptare

Në 4 shtator, Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë të Diasporës Shqiptare, ku u prezantuan një sërë aktiviteteve të të dyja organizatave, duke përfshirë çdo mundësi të mundshme për bashkëpunim me interes të përbashkët.

Takim me Dhomën Kombëtare të Noterisë

Në 22 tetor, Sekretari i AAB-së dhe bankat u takuan me përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Noterisë. Pjesëmarrësit diskutuan çështjet kryesore me të cilat përballen bankat dhe noterët gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm, si dhe mënyrat se si të forcojnë bashkëpunimin midis të dy palëve.

Takim i përfaqësuesve të AAB-së me Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave

Platforma e Re Strategjike për Përmirësimin e Cilësisë së të Dhënave për Depozitat dhe Depozituesit u diskutua në takimin e mbajtur në 20 tetor. Përmes konsultimeve konstruktive me anëtarët e skemës, kjo platformë strategjike synon të përcaktojë tregues të matshëm për secilën bankë ose shoqatën e kursim-kreditit për të përmirësuar cilësinë e të dhënave të shoqëruara me afatet kohore të përcaktuar nga ata, si dhe për të mundësuar monitorimin e përmirësimit nga këta tregues nga Agjencia.

TAKIME ME INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

Takim online me ekipin e FMN-së

Një ekip nga Departamenti i Çështjeve Fiskale të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i udhëhequr nga Znj. Suzanne Flynn, Z. Fritz Bachmair dhe Znj. Linda Spahia bashkëpunuan me autoritetet financiare dhe institucionet në vend për të mbështetur qeverinë shqiptare në menaxhim të rreziqeve të mundshme fiskale në lidhje me garancinë e qeverisë.

Në këtë drejtim, më 14 maj, sektori bankar prezantoi perspektivën e vetë lidhur me skemat e garancisë. Për këtë arsye, të dhënat e NPL-ve ishin temë diskutimi midis Sekretarit të Përgjithshëm të AAB-së, z. Brumbulli dhe anëtarëve të ekipit.

Takim me përfaqësuesit e FMN-së

Më 26 qershor, ekipi i FMN-së i udhëhequr nga Znj. Yan Sun zhvilloi një takim virtual me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së, z. Spiro Brumbulli. Pjesëmarrësit diskutuan mbi rreziqet kryesore me të cilat përballen sistemi bankar si pasojë e tërmetit, pandemisë Covid-19 dhe rënies ekonomike, pasojat e zhvillimeve të Covid-19 në Eurozonë në perspektivën ekonomike të Shqipërisë, pritshmërinë e tregut mbi kursin e këmbimit

në të ardhmen, zhvillimet dhe çështje të tjera të lidhura me to.

Më 21 shtator, u organizua një takim online me ekipin e FMN-së. Gjatë takimit, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së prezantoi pikëpamjet e tij mbi mjedisin e fundit makroekonomik dhe perspektivat për rritjen ekonomike afatshkurtër dhe afatmesme, ndryshimet kryesore dhe rreziqet kryesore për sistemin bankar pas përhapjes së Covid-19, zbatimin e masave lehtësuese të BOA-s për Covid-19, etj.

Takim me përfaqësuesit e Komisionit Evropian

Më 3 dhjetor, drejtuesit e AAB-së, Kryetari Z. Pedrazzi së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së zhvilluan një takim virtual me ekipin e Komisionit Evropian për të diskutuar Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë 2021-2023, sfidat e mjedisit të biznesit, tiparet dhe mundësitë për vitet e ardhshme.

Z. Pedrazzi theksoi se pavarësisht këtij viti të paprecedent dhe sfidues, ka përmirësime të shënuara në transformimin digjital dhe ekonominë e gjelbër.

Ekipi i Komisionit Evropian kryesohej nga Z. Javier Menendez Bonilla nga DG NEAR, dhe morën pjesë Andrew Williams dhe Christina Vanghele nga DG NEAR, Sarah Jurreit nga DG ECFIN dhe Kamil Valica nga DG Employment.

Takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore mbi pagesat e menjëhershme

Në koordinim me Bankën e Shqipërisë dhe në vijim të veprimeve të rëna dakord, ekipi i Grupit të Bankës Botërore zhvilloi një seri takimesh më 3 dhe 4 dhjetor me anëtarët kryesorë të industrisë sektoriale, për të diskutuar studimin e ekipit të skicës për skenarët e zbatimit të pagesave të shpejta në Shqipëri. Më 4 dhjetor, ekipi u takua me përfaqësuesit e AAB-së për të kuptuar më mirë mjedisin aktual operacional dhe strukturën e kostos për pagesa me pakicë, rastet e pagesave me pakicë që një FPS mund të shërbejë potencialisht dhe sfidat e mundshme në zbatimin e një sistemi të tillë në Shqipëri.

Takim konsultativ për Kuadrin e Bashkëpunimit

Ekipi Vendor i Kombeve të Bashkuara (UNCT) për Shqipërinë ka nisur procesin e përgatitjes për një Kuadër të ri Bashkëpunimi në përmbushjen e parimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (CF) për periudhën 2022-2026. Më 14 dhjetor, u organizua një takim virtual për të diskutuar Kuadrin e Bashkëpunimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara të propozuar për prioritetet dhe rezultatet e bashkëpunimit.

SHIFRA
RRETH
BANKAVE
ANËTARE



Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2020 ((1 EUR = 123.70 lekë; 1 USD = 100.84 lekë) (në mijë ALL)

Banka	Struktura e Aksionarëve		Vendi i origjinës	Aktive gjithsej (ALL000)	Hua neto (ALL000)	Investime në letra me vlerë (ALL000)	
						të Qeverisë Shqiptare	Të tjera
*  ALPHA BANK	Alpha Bank A.E.	100%	Greqi	77,033,448	33,642,214	7,417,912	12,567,177
 AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit Sh.p.k.	100 %	Shqipëri	87,064,729	29,278,082	35,146,559	
*  BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S.	100%	Turqi	421,900,552	93,512,681	126,149,941	78,209,341
	Renis Tershana	18.53%	Shqipëri				
	Aleksander Pilo	8.27%	Shqipëri				
	B.F.S.E. Holding BV	15.21%	Hollandë	246,777,346	106,809,269	44,774,499	38,883,028
	Amryta Capital LLP	6.45%	Angli				
	Të tjerë	51.10%					
 First Investment Bank	Fibank AD	100%	Bullgari	34,243,838	17,098,142	9,626,599	324,382
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A.	100%	Itali	188,630,803	50,902,837	66,546,466	5,527,255
	OTP NYRT	100%	Hungari	96,480,783	58,453,672	21,779,703	-
	ProCredit Holding AG & Co. KGaA	100%	Gjermani	35,446,845	25,298,202	1,293,444	-
	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH	100%	Austri	237,129,901	88,287,982	51,158,445	9,515,724
	Balfin Sh.p.k.	100%	Shqipëri	84,390,894	37,991,132	25,072,888	4,955,222
*  Banka e Bashkuar e Shqiperise United Bank of Albania	Islamic Development Bank	72.20%	Arabia Saudite				
	Eurosig Sh.a.	21.02%	Shqipëri	9,868,942	5,968,858	-	-
	Të tjerë	6.78%	Bahrein				
	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k.	92.24%	Albania				
	European Bank for Reconstruction and Development	4.22%	Britani e Madhe	71,862,316	31,661,639	23,968,643	964,079
	Individë	3.54%	Shqipëri				
GJITHSEJ				1,513,796,949	545,262,496	405,517,187	138,379,031

* Të dhëna të paaudituar

	Kapitali i vet (ALL000)	Depozita (ALL000)	Fitimi neto (ALL000)	Nr. i degëve	Nr. i punonjësve	Nr. ATM	Nr. i kartave të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E- banking	Mobile Banking	E- commerce
	9,173,697	62,930,067	218,419	34	419	49	40,002	34,512	5,490	1,246	✓	✓	✗
	10,312,414	68,199,118	1,064,080	21	365	30	15,483	14,559	924	-	✓	✗	✗
	49,584,036	334,879,723	6,396,697	64	940	101	374,919	326,118	48,801	6,779	✓	✓	✓
	18,570,041	217,994,494	909,036	58	964	71	188,895	121,180	6,053	1578	✓	✓	✓
	3,646,591	28,617,005	375,204	14	351	34	39,511	35,468	4,043	n/a	✓	✓	✗
	23,051,769	159,507,095	1,294,535	35	657	57	112,651	111,992	659	658	✓	✓	✗
	9,456,255	72,890,101	663,004	38	464	80	66,065	63,641	2,424	-	✓	✓	✗
	3,187,390	24,004,806	(440,616)	5	121	16	9,850	9,833	17	-	✓	✓	✗
	29,422,146	203,020,446	1,486,151	74	1,324	178	332,699	298,166	34,533	1,615	✓	✓	✓
	9,984,782	71,569,313	648,268	35	478	72	75,915	71,023	4,892	210	✓	✓	✗
	1,293,633	8,492,192	(148,620)	6	84	-	490	490	-	-	✗	✗	✗
	5,809,570	60,528,794	476,057	32	400	48	38,628	32,068	6,560	80	✓	✓	✓
	164,318,627	1,249,703,087	12,723,796	382	6,148	687	1,255,106	1,084,538	108,906	10,920			

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

Shoqata Shqiptare e Bankave

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E AKTIVITETEVE.....	2
PASQYRA E FLUKSIT MONETAR.....	3
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE.....	4-9

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin e organizates “Shoqata Shqiptare e Bankave”,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Shoqata Shqiptare e Bankave”, (“më poshtë referuar si “Organizata”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizates me datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e shpenzimeve sipas aktiviteteve dhe flukseve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Organizatës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë audituar nga një Auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pakualifikuar mbi ato pasqyra financiare në datë 2 qershor 2020.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizates për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizaten ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizates.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
23 mars 2021



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	5,649,688	7,075,012
Kontribute të arkëtueshme	5	288,990	2,435,400
Shpenzime të parapaguara	6	280,160	280,160
Totali i aktiveve afatshkurtra		6,218,838	9,790,572
Aktivitet Afatgjata			
Aktivitet e qëndrueshme, neto	7	743,274	923,593
Totali i aktiveve afatgjata		743,274	923,593
TOTALI I AKTIVEVE		6,962,112	10,714,164
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	8	728,933	3,015,125
Totali i detyrimeve afatshkurtra		728,933	3,015,125
Aktivitet Neto	9	6,233,178	7,699,039
TOTALI I DETYRIMEVE		6,962,112	10,714,164

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri në 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave janë përpiluar më 28 shkurt 2021 dhe nënshkruar nga:

 Spiro BRUMBULLI Sekretar i Përgjithshëm Shoqata Shqiptare e Bankave	 PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k Hartuesi
	

Pasqyra e Aktiviteteve

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TË ARDHURAT			
Të ardhura nga kuotat e anëtarësisë	10	23,239,500	27,033,500
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	10	4,303,950	5,933,825
Të ardhura të tjera	10	1,982,878	3,762,009
Të ardhura nga kuotat shtesë për raste emergjence	10	-	34,264,000
Totali i të Ardhurave		29,526,328	70,993,333
SHPENZIMET			
Amortizimi	7	(189,685)	(247,443)
Shpenzime organizimi për aktivitete	11	(8,391,416)	(13,503,627)
Shpenzime promovimi dhe publikime	12	(3,392,026)	(6,409,210)
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	13	(19,043,111)	(18,186,067)
Shpenzime të anëtarësisë për raste emergjente	13	-	(34,396,000)
Fitime / (Humbjet) nga kursi i këmbimit		24,050	(99,444)
Totali i Shpenzimeve		(30,992,188)	(72,841,791)
Ndryshimi në aktivet neto		(1,465,860)	(1,848,458)
Aktivitet Neto në fillim të vitit		7,699,039	9,547,497
Aktivitet Neto në fund të vitit		6,233,179	7,699,039

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>			
Teprica/(Deficiti) i të ardhurave ndaj shpenzimeve		(1,465,860)	(1,848,458)
Rregullime për:			
Amortizim	7	189,685	247,443
Llogari të arkëtueshme	5	2,146,410	314,971
Pagesa për llogaritë e pagueshme	8	(2,286,191)	70,190
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		(1,415,956)	(1,215,865)
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	7	(9,368)	(35,000)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		(9,368)	(35,000)
RËNIE NETO E MJETEVE MONETARE		(1,425,324)	(1,250,865)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	4	7,075,012	8,325,877
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	4	5,649,688	7,075,012

Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shenime për pasqyrat financiare

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqipëtare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 12 anëtarë, mbi baza vullnetare: Banka Alpha Albania sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Credins sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka Intesa SanPaolo Albania sh.a., Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Tiranë sh.a. dhe Banka Union sh.a.

ABB ka pasur 6 punonjës me 31 dhjetor 2020 (2019: 6).

2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lekë (Lekë), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

(a) Kosto Historike

Elementët në pasqyrat financiare janë njohur me koston historike.

(b) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijmësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Shoqata Shqiptare e Bankave do të ketë vijmësi, dhe se nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

Organizata nuk e ndërpreu punën e saj gjatë pandemisë globale. Gjithashtu edhe të gjitha Bankat anëtare të Shoqatës vijuan aktivitetin e tyre pa ndërpreje, ndryshe nga pjesa më e madhe e entiteteve të cilat paten efekte prej masave kufizuese të qeverisë.

Gjatë vitit 2020 të gjithë donatorët e organizatës i kanë disbursuar fondet e tyre në bazë të Statutit të organizatës në përputhje me planin e aktiviteve për vitin 2020, me përjashtim të kështit të fundit të vitit 2020 të miratuar me vendimin e asamblese të datës 10.12.2020. Asambleja e përgjithshme e organizatës me anë të vendimit 4 datë 10.12.2020 ka miratuar edhe planin financiar për vitin 2021 për shumën totale prej 33,146,580 leke.

Organizata vijon me implementimin e masave për parandalimin e ndikimeve negative të Pandemisë në aktivitetet e saj dhe vlerëson se do të vijojë aktivitetin bazuar mbi parimin e vijmësisë, për një periudhë kohe të paktën për 12 muajt e ardhshëm.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

I. Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

II. Transaksionet në monedhë të huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un. Të gjitha kontributet dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve janë në Lekë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

Kursi i këmbimit më

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
LEKË/EUR	123.7	121.77

III. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

IV. Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksave vendore.

4. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari rrjedhëse në Lekë	3,743,272	6,737,272
Llogari rrjedhëse në Euro	1,892,238	282,748
Para në arkë	14,178	54,992
Gjithsej	5,649,688	7,075,012

5. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrime nga anëtarët	288,990	2,435,400
Gjithsej	288,990	2,435,400

6. Shpenzime të parapaguara

Shpenzime të parapaguar përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Garanci qira	280,160	280,160
Gjithsej	280,160	280,160

7. Aktivet Materiale Afatgjata

Aktivët e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2019	2,060,691	1,959,306	4,019,997
Shtesat gjatë vitit 2020	-	9,368	9,368
Pakësimi gjatë vitit 2020	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2020	2,060,691	1,968,673	4,029,364
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2019	1,703,844	1,392,560	3,096,404
Amortizimi gjatë vitit 2020	47,369	142,316	189,685
Pakësimi gjatë vitit 2020	-	-	-
Në 31 Dhjetor 2020	1,751,213	1,534,876	3,286,090
Vlera Neto			
Në 31 Dhjetor 2019	356,847	566,746	923,593
Në 31 Dhjetor 2020	309,478	433,797	743,274

8. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Tatimi mbi të ardhurat personale	371,973	362,776
Kontributet e Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	216,641	216,949
Furnitorë	125,570	2,435,400
Tatim në Burim	14,749	-
Gjithsej	728,933	3,015,125

9. Aktivët Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të AAB në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivet neto, paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivët neto përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e ABB.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Balanca e mbartur në fillim të periudhës	7,699,039	9,547,496
Rritje/(Ulje) në aktivet neto	(1,465,860)	(1,848,458)
Balanca e mbartur në vitin e ardhshëm	6,233,179	7,699,039

10. Të ardhurat

Të ardhurat e organizatës përfaqësojnë vlerën e fondeve të marra gjatë vitit 2020 nga Bankat për realizimin e aktiviteteve në përputhje me statutin e organizatës.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	23,239,500	27,033,500
Sponsorizime nga bankat	4,303,950	5,933,825
Të ardhura nga trajnime për bankat anëtare	1,982,878	3,762,009
Kuota shtesë për raste emergjente	-	34,264,000
Gjithsej	29,526,328	70,993,333

Kuotat shtesë për raste emergjente lidhen me rastet e tërmeteve të 21 Shtatorit 2019 dhe 26 Nëntorit 2019, që goditën vendin. Këto kuota janë dhuruar Prefekturës së Korçës për rastin e tërmetit të 21 Shtatorit dhe Qeverisë Shqiptare për rastin e tërmetit të 26 Nëntorit.

11. Shpenzime organizimi për aktivitete

Shpenzime organizimi për aktivitete përfaqësojnë shpenzime për aktivitete kryesore sipas kërkesave të Bankave anëtare në përputhje me statutin e organizatës.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Trajnime për bankat anëtare	6,322,222	6,688,638
Evente dhe Workshop	1,024,884	5,398,944
Anëtarësime	1,044,310	1,057,600
Udhëtime	-	358,455
Gjithsej	8,391,416	13,503,627

12. Shpenzime promovimi dhe publikime

Shpenzime promovimi dhe publikimi analizohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Publikime	3,306,710	3,364,027
Materiale informative dhe publicitet	85,316	3,045,184
Gjithsej	3,392,026	6,409,210

13. Shpenzimet të përgjithshme dhe të administrimit

Shpenzime të përgjithshme dhe të administrimit analizohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Paga personeli	11,753,997	11,272,229
Qira	2,971,440	2,956,500
Kontribute për sigurime	1,247,582	1,164,004
Shpenzime komunikimi	1,145,130	1,150,483
Shpenzime konsulence	880,090	462,990
Shpenzime të tjera	344,427	343,707
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	288,395	338,600
Sigurim shëndeti	186,225	182,565
Shpenzime utilitare	138,600	161,887
Shërbime përkthimi	36,222	68,589
Komisione bankare	21,267	43,012
Taksa lokale	15,000	15,000
Abonime	14,175	17,500
Noterizime	560	9,000
Shpenzime për raste të jashtëzakonshme	-	34,396,000
Gjithsej	19,043,111	52,582,067

Shpenzime për raste të jashtëzakonshme lidhen me kuatat dhuruar Prefekturës së Korçës për rastin e tërmetit të 21 Shtatorit dhe Qeverisë Shqiptare për rastin e tërmetit të 26 Nëntorit.

14. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Çështje ligjore

Më 31 dhjetor 2020, nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër Organizates apo nga Organizata.

Angazhime per qera

Organizata ka angazhime për kontraten e qerasë për ambientet për zhvillimin e akviteve për periudhën maksimumi deri në një vit 1.

15. Transaksione me palët e lidhura

Organizata ka pasur transaksione me palët e lidhura përgjatë rrjedhës normale të biznesit. Transaksionet kryesore janë ato të lidhura me fondet e marra nga Bankat.

16. Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Organizatës nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime shtesë në këto pasqyra financiare.



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE